# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

| Nr. Rën dor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e kthimit të përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfund imit të kërkesë s | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 06.01.2025 | Kërkesë për informacion në lidhje me këto pyetje:<br>- Sa banesa sociale ishin planifikuar të ndërtoheshin dhe të përfundonin në Vlorë gjatë vitit 2024?<br>- Pse këto punime nuk janë përfunduar deri më tani?<br>- Cilat janë disa nga problemet kryesore që janë hasur gjatë realizimit të projektit dhe cilat masa po merren për adresimin e tyre?<br>- Cili është plani juaj për banesat sociale në qytetin e Vlorës për vitin 2025? | 15.01.2025 | Enti Kombëtar i Banesave në qytetin e Vlorës ka planifikuar ndërtimin e 2 (dy) banesave, të cilat janë më tipologji 8kat banimi dhe shërbimi dhe një kat parkimi nën tokë. Në rastin e objektit që ju interesoheni, theksojmë se, janë hasur disa problematika ligjore dhe teknike të cilat kanë ndikuar në ngadalësimin e punimeve në këtë objekt. EKB është duke punuar që kjo situatë të zgjidhet sa më parë, duke i bërë me dije nëpërmjet komunikimeve shkresore, përgjegjësitë ligjore Bashkimit të Operatorëve Ekonomik për vonesat e shkaktuara si dhe nëse situata në këtë objekt nuk do të zgjidhet, atëherë EKB përveç penaliteteve sipas ligjit dhe kontratës së nëshkruar, do të marrë masa ekstreme deri në prishjen e saj.<br>Në lidhje me investimet e tjera në qytetin e Vlorës, EKB është në kontakt të vazhdueshëm me bashkitë në të gjithë vendin, specifikisht me Bashkinë që ju interesoheni, për të përmbushur nevojat për strehim dhe për të planifikuar investime të tjera në një periudhë sa më të afërt. | E plotë | Nuk ka |